



USAID
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД



Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës
- Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Ministria e Arsimit dhe Shkencës -
Byroja e Zhvillimit të Arsimit



Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) në bashkëpunim me Projektin e USAID-it për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë" dhe Institutin Maqedonas për Media publikojnë:

THIRRJE PUBLIKE **për paraqitjen e aplikacioneve për mësimdhënës-trajnues në fushën e edukimit mediatik**

Ftojme të gjithë mësimdhënësit dhe mësimdhënësit-mentorë të interesuar nga shkollat fillore komunale të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim, të aplikojnë në këtë thirrje publike brenda afatit të paraparë.

Thirrja publike është pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të realizuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe BZHA së bashku me ekipin e Projektit të USAID-it për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë", ku një nga qëllimet kryesore është vendosja e edukimit mediatik në programet mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm.

Qëllimi kryesor i projektit është tu mundësojë të rinjve të fitojnë aftësi dhe ndërgjegjësim për edukimin mediatik, në mënyrë që ata të kenë qasje kritike ndaj informacionit dhe të ndërtojnë rezistencë ndaj dezinformatave, misinformatave, gjuhës së urrejtjes, teorive të konspiracionit dhe formave të tjera të manipulimit.

Mësimdhënësit - trajnues do të përfshihen në trajnime për trajnerë përmes të cilëve do të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me edukimin mediatik, të menduarit kritik dhe parimet bazë dhe qasjet metodologjike për ligjërimin e përmbajtjeve në këtë fushë. Mësimdhënësit-trajnues do të pajisen gjithashtu me një sërë materiale që do tu ndihmojnë në planifikimin, përgatitjen dhe realizimin e orëve duke përfshirë qasjet dhe metodat e mësimdhënies në lidhje me edukimin mediatik, duke i inkurajuar nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike.

Nga viti akademik 2022/2023 dhe gjatë viteve të ardhshme shkollore, mësimdhënësit trajnues do të angazhohen për të zhvilluar trajnime për kolegët e tyre mësimdhënës për njohjen e tyre me edukimin mediatik, metodat e mësimdhënies, si dhe planifikimin, organizimin dhe realizim të mësimdhënies duke përfshirë konceptet e edukimit mediatik dhe të menduarit kritik.

Parashikohet që sa më shumë mësimdhënës të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me edukimin mediatik në mënyrë që ai të integrohet në mënyrë përkatëse në lëndë të ndryshme. Trajnimet do të organizohen, monitorohen dhe certifikohen nga Projekti i USAID-it për edukim mediatik dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit.

Kushtet për pjesëmarrje në thirrjen publike për mësimdhënës-trajnues në fushën e edukimit mediatik, janë si më poshtë:

1. të paktën pesë vjet përvojë pune si mësimdhënës;
2. i punësuar për kohë pune të pa përcaktuar;
3. përmbushjen e standardeve profesionale për mësimdhënës dhe mësimdhënës-mentor dhe
4. përvojë paraprake në mbajtjen e trajnimeve për mësimdhënës.

Aplikacionin për Thirrjen mund ta gjeni në këtë [link](#).

Aplikacioni në formë elektronike duhet të dërgohet në Institutin Maqedonas për Media në adresën e emailit: povici@mim.org.mk, me shënimin "Aplikim për Thirrjen për Mësimdhënës-Trajnues- <emri dhe mbiemri>".

Të gjitha pyetjet rreth thirrjes mund të dërgohen në adresën: ivonae@mim.org.mk, **jo më vonë se 29 mars 2022.**

Komisioni përzgjedhës do të përbëhet nga përfaqësues të MASH, BZHA dhe Projekti i USAID-it për Edukim mediatik.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikacioneve për mësimdhënës-trajnues është deri më 6 prill 2022. Çdo aplikacion i paraqitur pas kësaj date nuk do të merret parasysh dhe nuk do të rangohet.

Projekti i USAID për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë" është program pesëvjeçar i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) i zbatuar nga IREX në bashkëpunim me partnerët lokalë Instituti Maqedonas për Media (IMM), Instituti për Studime të Komunikimit (ISK) dhe Forumi Arsimit Rinor (FAR).